

AKT- THEMELIMI STATUTI

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ANEL & CO” SH.P.K

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

(1) Sot, në ditën e Mërkurë, më 03.01.2018, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“ANEL & CO” Sh.p.k**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Z. Aleksandër Rogo**, i biri i Niko, i datëlindjes 31.01.1986, lindur dhe banues në Gjirokastër, në adresën, Ruga “Tahir Kadare”, Ap.2, Pl.1029 mbajtës i Kartes së identitetit nr personal **H10711049A**.

Të cilët kanë vendosur miratimin e statutit te ri të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn ne fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 2 OBJEKTI

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Projektim ne fushen e urbanistikes dhe arkitektures. Tregti, import-eksport , prodhim, përpunim e shërbime në fushën e materialeve të ndërtimit, të industrisë, etj. Vleresues i pasurive te paluajtshme dhe ekspert per pasurite e paluajtshme. Vleresim te linjave te prodhimit, industriale, makineri dhe paisje. Aktivitet zhvillimor turistik, shitblerje pasurish te paluajtshme, guide turistike. Projekte inxhinierike për linjat e përpunimit industrial, kërkime dhe studime të ndryshme në fushën e fizibilitetit për zbatimin e projekteve të ndryshme dhe asaj të marketingut. Ndërtim në fushën civile, projektim, mirëmbajtje pastrim si dhe cdo aktivitet tjeter tregëtar që lidhet me fushën e ndërtimit” Punime hidroizolim, termoizolim te gjitha llojeve, tregtim i materialeve te tyre. Punime dhei, sistemime, taracime terrenesh, punime hekuri, karpantjerie, ndertime civile dhe ekonomike, kulturore, tregtare, ndertime rruge, veshje me asfaltobeton te rrugeve, sistemim, asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore e hekurudhore, ndertime ujesjelles e kanalizime, ndertim vepra kullimi, ujite toke e impjante vaditeze, rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash. Ndertim pallate, qendra biznesi, qendra sportive. Projektim ne fushen e ndërtimit. Shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, ndermjetesim per dhenie me qira te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Tregtim me shumice e pakice te gjitha artikujve industrial, ushqimore, konfeksione, elektroshtepiak, hidrosanitare, materiale ndertimi, materiale druri. Tregtim pije alkolike dhe jo alkolike. Veprimitari ne



fushen e turizmit, hotelerise, barrestorant. Import-eksport i ketyre artikujve. Transport mallrash te gjitha llojeve. Veprimtari ne fushen e pastrimit kimik. Trajnjime.

Financimi, ndërtimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike.

Tregtimi i naftës dhe i benzinës me shumicë e pakicë. Tregti gazi të lëngshëm për djegie (GLN), i hidrokarbureve të çdo lloji dhe vajra lubrifikantë. Tregti bombolash gazi të lëngshëm për djegie Standarti EU dhe i aksesorëve të ndryshëm të tyre, riparimi dhe kolaudimi i bombolave të gazit të lëngshëm për djegie Standarti EU. Tregtimi me pakicë e shumicë si dhe shpërndarja e naftës, benzinës, gazit dhe nënprodukteve e derivateve të tyre. Ndërtimi, marrja me qera e fabrikave, instalimeve, rafinerive, magazinave, depozitave, karburanteve, vajgurit, benzinës, naftës etj. Marrja dhe dhenia me qira apo nenqira te pikave te ndryshme te tregtimit te gazit te lengshme apo karburanteve si dhe dyqaneve per shitjen e bombolave te gazit. Për rafinerimin, prodhimin, përpunimin, depozitimini e naftës, benzinës, gazit dhe nënprodukteve e derivateve të tyre. Transportin e naftës, benzinës, gazit dhe nënprodukteve e derivateve të tyre me të gjithë mjetet e transportit detar, tokësor të gjitha kapaciteteve si dhe tregtimin e makinerive, pajisjeve dhe njohurive në këtë fushë, etjer. Agjenci detare dhe spacionere, agjenci e transportit detar dhe tokësore, kombëtar dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe agjenci doganore. Import-eksport dhe përpunjim aktiv i lëndëve të para dhe gjysëm produkteve. Veprime e operacione të tjera financiare, juridike, tregtare e civile që i shërbejnë objektit të shënuar më lart dhe në funksion të zhvillimit e rritjes së shoqërisë.

Prodhimi, shitja, importimi, eksportimi, tregtimi me rruge dhe transaksione te ndryshme te energjise elektrike. Prodhim te energjise elektrike duke shfrytezuar burimet e energjise te cilat gjenden ne natyre dhe jane te rinovuaeshme, si ajo hidrike, diellore, e eres etj.

Import – eksport, tregti me shumice dhe pakice te pllakave te llojeve te ndryshme, hidrosanitare, elektroshtepiakë, artikuj te tjere si, koll, stuko, gipse, bojra per lyerje, verniqe, artikuj te ndryshem ushqimore dhe industrial, makineri te ndryshme.

Tregti bojra dhe artikuj te ndryshem industriale. Punime te ndryshme per lyerje dhe izolime.

Ushtrimi të çdo veprimtarie të ligjshme, të lejueshme për formë e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit tregtar Nr.9901, dt.14.04.08).

Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjeter si breda dhe jashte territorit të Republikës së Shqipërisë, që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe finanziar, që lidhet drejtëdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj.


Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarine për një periudhe kohore të pacaktuar.

NENI 4 SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga “Tahir Kadare”, Ap.2, Pl.1029, Gjirokastër.



KREU II KAPITALI

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.800.000 (njëmillion e tetëqind mijë) Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:

1. Z. Aleksandër Rogo, i biri i Niko, i datëlindjes 31.01.1986, lindur dhe banues në Gjirokastër, në adresën, Rruga “Tahir Kadare”, Ap.2, Pl.1029 mbajtës i Kartes së identitetit nr personal H10711049A.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:


- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, të cilët gëzojnë të drejtëna e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8 ORGANI VENDIMARRES



Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit Nr. 9901 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11 **MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 12 **PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


NENI 13 **ADMINISTRIMI**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Administrator i shoqërisë caktohet **Z. Aleksandër Rogo**.

Speciment i firmes



NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- I. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- II. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- III. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:



- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

**KREU IV
VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

**NENI 16
VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**NENI 17
EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

**KREU V
PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË
NENI 18
PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;


b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.



Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19
RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare." I ndryshyar.

NENI 20
BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 21
MOSMARRËVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K U
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ANEL & CO" SH.P.K.

1. Z. Aleksandër Rogo ...Aleksandër Rogo



V E N D I M
date 03.01.2018

*I Asamblesë se Përgjithshme i Ortakëve të shoqërisë
"ANEL & CO" Sh.p.k.*

Në Tiranë, sot më datën 03.01.2018, u mblohdh Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të shoqërisë "ANEL & CO" Sh.p.k , Z. Aleksandër Rogo zotëruesh i 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, me rend e dite si më poshtë vijon:

Rend Dite:

1. Themelimi i shoqërisë ANEL & CO sh.p.k
2. Miratimi i statutit të shoqërisë ANEL & CO sh.p.k në përputhje me ligjin e ri Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
3. Emërimin si administrator të shoqërisë z. Aleksandër Rogo.
4. Miratimin e të dhënavë që njoftohen vullnetarisht:
 - e-mail: anelgroup.shpk@gmail.com

Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, pasi diskutoi me cështjet e përcaktuara në rendin e ditës.

V E N D O S I:

1. Themelimi i shoqërisë "ANEL & CO" sh.p.k.
2. Miratimi i statutit të shoqërisë "ANEL & CO" sh.p.k në përputhje me ligjin e ri Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
3. Emërimin si administrator të shoqërisë z. Aleksandër Rogo.
4. Të dhënat që njoftohen vullnetarisht:
 - e-mail: anelgroup.shpk@gmail.com
5. Ngarkohet administratori Aleksandër Rogo, të kryej cdo procedurë të nevojshme ligjore për regjistrimin e këtyre ndryshimeve në QKR.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ortaku.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"ANEL & CO "SH.P.K

Aleksandër Rogo

